MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË GRAMSH

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Gramsh me objekt: "Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj"."dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 137, datë 28.9.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 572/14 , datë 28.9.2012 , dërguar **z. Dritan Bici**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa për zbatimin e plotë te rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të dërguara me shkresën nr. 116/8, datë 16.7.2010.

Menjëherë

2. Të bëhet vetëvlerësimi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, sipas komponentëve, duke paraqitur: mjedisin e kontrollit; aktivitetet e kontrollit dhe monitorimin. Në mjedisin e kontrollit të përcaktohen faktorët, si integriteti, vlerat etike, si dhe profesionalizmi i punonjësve të njësisë, filozofia dhe stili i punës së titullarit, mënyra se si drejtuesi shpërndan detyrat dhe ngarkon përgjegjësitë apo si organizon dhe zhvillon punonjësit në njësi, si dhe përkushtimi dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

Menjëherë

3. Të merren masa, që në hartimin e planit të buxhetit, të ketë relacion shpjegues, ku të jenë analizuar hollësisht. Objektivat që do të realizohen në kuadër të politikave të zhvillimit, rritja e të ardhurave për të krijuar mundësi më të mëdha për financimin e projekteve të ndryshme, rritja e shpenzimeve për investime, duke ulur shpenzimet operative, të cilat të planifikohen të detajuara, etj.

Menjëherë

4. Të merren masa, që të rishikohet struktura organizative me synim reduktimin e numrit të punonjësve, në përputhje me mundësitë financiare të bashkisë.

Menjëherë

5. Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për gjetjen e adresave dhe arkëtimet e debitorëve e sidomos për ato pa shpresë arkëtimi.

Vazhdimisht

6. Të merren masa nga Drejtoria e Financës, për hapjen e kartelave për çdo element të aktiveve të qëndrueshme, të rezultuan të pa hapura, të pasqyruara në llogaritë : 210 "Toka, troje, terrene" me vlerë 4,853,420 lekë**;** 212 "Ndërtime e konstruksione" me vlerë 265,878,397 lekë; 213 "Rrugë, mjete, vepra ujore" me vlerë 189,587,416 lekë; 214 "Instalime, makineri pajisje e vegla pune" me vlerë 2,707,200 lekë, ku të pasqyrohet për çdo aset, origjina, viti i krijimit, vlera fillestare dhe amortizimi (për ato që nuk është llogaritur amortizimi), etj.

Menjëherë

7. Nga ana e Njësisë së Prokurimit të Autoritetit Kontraktor (Bashkia e Qytetit Gramsh) të inventarizohen në mënyrë të rregullt dokumentet e të arkivohen në përputhje me ligjin "Për Arkivat" dosjet e prokurimeve.

Vazhdimisht

8. Nga ana e Zyrës së Taksave e Tregjeve pranë Bashkisë të merren masa për përmirësimin e organizimit të punës dhe të ndiqet në vazhdimësi arkëtimi i vlerave debitore, për të gjitha subjektet, për vlerën 502,835 lekë

Vazhdimisht

9. Nga Drejtoria Ekonomike pranë Bashkisë të merren masa për arkëtimin e vlerave debitore prej 1,142,274 lekë, për personat qiramarrës të objekteve të dhëna nga Bashkia për vitet 2010 dhe 2011 me qëllim banimi dhe biznesi.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

10. Nga Zyra e Taksave dhe Tregjeve pranë Bashkisë të hartohen e miratohen planet vjetore për ushtrimin e kontrolleve sipas pikës 10"Kontrolli tatimor", të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 6.02.2007, dhe të evadohen rezultatet sipas procedurave ligjore në fuqi.

Vazhdimisht

11. Të merren masa nga ana e Policisë Bashkiake për hartimin e planit vjetor dhe të dokumentohet puna e përditshme në mënyrë shkresore, duke krijuar regjistër të veçantë për gjobat dhe urdhër ekzekutimet që dalin nga Kryetari i Bashkisë.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

12. Nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV), të bashkëpunohet me Zyrën e Urbanistikës, për të evidentuar ndërtimet pa leje, duke aplikuar gjoba ndaj subjekteve ndërtuese të kundërligjshme, me qëllim mbajtjen nën kontroll, administrimin dhe zhvillimin e territorit

Vazhdimisht

13. Bashkia Gramsh, në bashkëpunim me Prefektin e Qarkut Elbasan, me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve dhe me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve sh.a. Gramsh, të ngrenë një grup pune, ad hoc. Ky grup pune të analizojë gjendjen e Depos së Ujit të Pijshëm 2000 m3 duke nxjerrë përgjegjësitë dhe t'i japë zgjidhje problemit. Ky proces të kryhet me transparencë të plotë, duke pasur parasysh impaktin social në komunitet dhe vënien e Depos së Ujit në shërbim të banorëve.

Menjëherë

14. Nga Bashkia Gramsh (për ish nëpunësit e larguar nga puna) të njoftohet Departamenti i Administratës Publike, për rastet kur mos ushtrimi i detyrës administrative nga ana e tyre, ka ndikuar në funksionimin administrativ të Bashkisë, mbështetur kjo në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

B. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

Nga Bashkia Gramsh të merren masa, të bëhen kontabilizimet përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit në vlerën: **2,055,003 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe ato ligjore si dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Për vlerën **854,795 lekë,** për **104 sportistë të futbollit të Klubit Sportiv Gramsh,** pasi kanë përfituar pagese tepër, në kundërshtim me nenin 33 pika "f" të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Menjëherë

2. Për vlerën **492,750 lekë**, të shkaktuar nga **shoqëria sipërmarrëse Pastrim Gjelbërim** [redacted] sh.p.k. pasi ka përfituar pagese tepër për sigurime shoqërore e shëndetësore në kryerjen e shërbimit të pastrimit, në kundërshtim me nenin 10 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshime.

Menjëherë

3. Për vlerën **224,400 lekë,** për personin fizik [redacted] e cila përfaqëson pagesë të tepërt për realizimin e projektit dhe aktivitetit kulturor në organizimin e festivalit të këngës për fëmijë viti 2010. Në kundërshtim me pikat 8 a, b të nenit 3 dhe nenin 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004; VKM nr. 1195, datë 05.8.2008 "Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e programeve a të reklamave etj. nga organet e administratës shtetërore";VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 " Për përcaktimin e rregullave

për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura".

Menjëherë

4. Për vlerën **138,230 lekë**, të shkaktuar nga subjektet **"[redacted] dhe [redacted]** përfaqësuar me prokurë nga [redacted] administratori i operatorit ekonomik "R." sh.p.k. për volume punimesh të pa kryera, sipas kontratës për punë publike nr. 2076, datë 10.9.2010 dhe të raportuara në situacionin përfundimtarë për prokurimin me objekt: "Rikonstruksion, sistemim e asfaltim rruga 18 Gushti, nga segmenti banesa nr. 75, deri tek banesa nr. 63" Gramsh.

Menjëherë

5. Për vlerën **116,200 lekë,** të shkaktuar nga personi fizik [redacted] e cila ka përfituar pagesë tepër për kryerjen e shërbimit larje makine, në kundërshtim me pikat 8 a, b të nenit 3 dhe nenin 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004; pikën 3, të nenit 12, pikën 2 të nenit 16 dhe pikën 5 të nenit 23, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe me kreun VI pika 2 të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar dhe Udhëzimit APP nr. 2, datë 18.2.2008 dalë në zbatim të tij.

Menjëherë

6. Për vlerën **106,000 lekë**, të shkaktuar nga subjekti [redacted] përfaqësuar nga administratori z. B. P. për volume punimesh të pa kryera, sipas kontratës për punë publike nr. 759, datë 25.4.2011, dhe të raportuara në situacionin përfundimtar për prokurimin me objekt: "Sistemim asfaltim, rruga nga kthesa e ish SMT deri tek rruga N. Zh. Gramsh.

Menjëherë

7. Për vlerën **84,600 lekë**, të shkaktuar nga subjektet [redacted] **dhe** [redacted] përfaqësuar me prokurë nga z. R. B. administratori i operatorit ekonomik [redacted]. për volume punimesh të pa kryera, sipas kontratës për punë publike nr. 928, datë 19.4.2011, dhe të raportuara në situacionin përfundimtarë për tenderin me objekt: "Sistemim asfaltim, sheshi tek agjencia e transportit të udhëtarëve" Gramsh.

Menjëherë

8. Për vlerën **38,028 lekë,** të shkaktuar nga **shoqëria sipërmarrëse Pastrim Gjelbërim** [redacted] sh.p.k. pasi ka përfituar pagesë tepër për kryerjen e shërbimit të pastrimit, në kundërshtim me nenet 5, 12 dhe 13 të kontratës "Mirëmbajtje me sipërmarrje të pastrimit, evadimit të mbeturinave në qytetin e Gramshit, datë 30.6.2010.

Menjëherë

C. <u>MASA ADMINISTRATIVE</u>

Bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit",të ndryshuar me nenin 2 të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007, për shkelje të nenit 7, pikat 1, 3, 4, 17, 18 dhe 19 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001" Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pikat, 8, 8/1, 8/2 dhe 10 të Kreut II dhe pikat 4, 5 të Kreut III të UKM nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" ti propozohet Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik Vendor, të Bashkisë Gramsh që të gjobisë në shumën **50.000** lekë, secilin nga personat e mëposhtëm:

1[redacted] [redacted] në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin "Rikonstruksion, sistemim e asfaltim rruga 18 Gushti, nga segmenti banesa nr. 75, deri tek banesa nr. 63" Gramsh, pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se janë raportuar punime të pa kryera në vlerën 138,230 lekë, sipas preventivit dhe kontratës nr. 2076, datë 10.9.2010.

2. [redacted] [redacted] në cilësinë e administratorit të shoqërisë mbikëqyrëse [redacted] të punimeve në dy objektet, si me poshtë:

- "Sistemim asfaltim, rruga nga kthesa e ish SMT deri tek rruga N. Zh." Gramsh, pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se janë raportuar punime të pa kryera në vlerën 106,000 lekë, sipas preventivit dhe kontratës nr. 759, datë 25.4.2011

- “Sistemim asfaltim, sheshi tek agjencia e transportit të udhëtarëve” Gramsh, pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se janë raportuar punime të pa kryera në vlerën 84,600 lekë, sipas preventivit dhe kontratës nr. 927, datë 19.04.2011.

Menjëherë

D. MASA DISPLINORE

Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikat 1 dhe 2 të VKM nr. 306, datë 13.6.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

D.1. “Largim nga shërbimi civil”, neni 25, pika 3, germa “d”

Për **z.** [redacted] me detyrë Kryeinspektor i INUV të Bashkisë Gramsh gjatë periudhës 25.7.2012 e në vazhdim, me motivimin:

Për mos ushtrim të detyrës së kontrollit mbi territorin si dhe për mos aplikim gjobe për shkeljet e konstatuara në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, në kundërshtim me, germën “b” të nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar.

D.2. *“ Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, germa “a”*

Për **z.** [redacted] me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike pranë Bashkisë Gramsh për periudhën e auditimit viti 2010 dhe 2011 e në vazhdim, me motivimin: Për mos zbatimin e procedurave për plotësimin e dosjes së praktikave me dokumentacionin përkatës të përcaktuara në, VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 dhe VKM nr. 529, datë 08.6.2011 për kontratat e qirasë të lidhura nga Bashkia Gramsh me persona për qëllim strehimi dhe biznesi për vitet 2010 dhe 2011.

Shënim:

Për ish-punonjësit e mëposhtëm:

- **z.** [redacted] me detyrë ish Kryeinspektorit të INUV të Bashkisë Gramsh (për vitin 2011 deri në datë 23 .7.2011)
- **zj.** [redacted] me detyrë ish Drejtoreshë e Drejtorisë së Taksave e Tregjeve pranë Bashkisë Gramsh (për vitin 2010 deri më datë 19.9.2011)
- **Z.** [redacted] me detyrë ish inspektor i Policisë Bashkiake (për vitin 2010 deri me datë 25.03.2010)
- **znj.** [redacted] me detyrë ish specialiste e nivelit të lartë në Drejtorinë Ekonomike, (për vitin 2010 deri në datë 10.7.2011)
- **znj.** [redacted] me detyrë ish - Specialiste e Financës (për periudhën 01.01.2010 deri më 31.12.2011) aktualisht në pension pleqërie,
- **z.** [redacted] me detyrë ish - Drejtor i Financës (për periudhën viti 2010 deri më 31.7.2011).

Nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimin e tyre. Në kushtet kur mos ushtrimi i detyrës administrative nga ana e tyre ka ndikuar në funksionimin administrativ të institucionit, atëherë ngarkohet Bashkia të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH për këto persona.

E. DËRGIM MATERJALI AUDITIMI PËR VLERËSIM ,ORGANIT TË PROKURORISË

Mendojmë që konstatimet e grupit të auditimit në lidhje me auditimin e marrjes në dorëzim, kolaudimin dhe vënien në punë të objektit “Depo e Ujit të Pijshëm me kapacitet 2000m^3” të ndërtuar nga Investitori Bashkia Gramsh dhe sipërmarrësi [redacted] sh.p.k. ti dërgohen Organit të Prokurorisë me qëllim vlerësimi e përcaktimi të veprës penale në raport me shkeljet e konstatuara dhe përgjegjësinë penale për personat përgjegjës të trajtuar në materialin e Auditimit.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Muhamed Kavaja, Jonel Nasto, Përparim Gjuzi dhe Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Bajram Lamaj, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT